



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr 394/2

Gramsh, më 25.02 /2026

VENDIM
NR.08. Datë 30.01.2026
Për

Për miratimin e shumës së bashkëfinacimit të subvencionimit të qerasë

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 30.01.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e sektorit të Emergjencave Civile dhe Strehimit “Për miratimin e shumës së bashkëfinacimit të subvencionimit të qerasë”, në mbështetje të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, në VKM nr.459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirës ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin”, në Udhëzimin e MFE, nr.31, dt.18.11.2019, “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2;

Vendosi:

Të miratohet shuma e bashkëfinacimit për subvencionimin e qirasë në masën **24 000** (njëzet e katër mijë) lekë.për një familje në nevojë bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.

- I. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë, drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Sektori I Emergjencave Civile dhe Strehimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari I Këshillit

Xhulja Gjini

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Enis Zani

